

# enterprise europe

QERSHOR 2016

## EEN-ALBANIA NEWSLETTER #1

### ANËTARËSIMI NË RRJETIN EUROPIAN TË NDËRMARRJEVE

Enterprise Europe Network (Rrjeti Evropian i Ndërmarrjeve) është një instrument i rëndësishëm në strategjinë e BE-së, i cili sjell së bashku rreth 600 organizata mbështetëse të biznesit nga më shumë se 60 vende të botës, me qëllim suportin për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mbi mundësitë e të bërit biznes në Tregun e Përbashkët të BE-së.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) me synimin dhe objektivin për ti ardhur sa më shumë në ndihmë biznesit në kërkim të tregjeve të reja dhe partnerëve të fuqishëm nëpër botë, aplikoi

në Janar të 2015 për të qënë pjesë e Rrjetit Evropian të Ndërmarrjeve (EEN) për të përfituar mbështetje financiare për aktivitetet që do të organizohen në Shqipëri në shërbimet që do të ofrohen në mbështetje të bizneseve.

Tetë organizata partnere shqiptare janë pjesë e këtij Rrjeti. Synimi kryesor është të ndihmojë bizneset shqiptare të shfrytëzojnë mundësitë e të bërit biznes në tregun e përbashkët të BE-së.

Enterprise Europe Network në Shqipëri ofron një portofol të plotë shërbimesh për biznesin ku përfshihet, dhënia e informacionit për biznesin,

legjislacionin, standardet e BE-së, shërbime individuale për kompanitë për të gjetur tregje të reja, akses në financë, rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, organizime veprimtarish si trajnime, seminare, etj. me tematika të ndryshme.

Gjithashtu krijon mundësi për partneritet me biznese të vendeve të tjera të BE-së, nëpërmjet organizimeve të misioneve të biznesit dhe përgatitjes së profileve të kompanive shqiptare që ofrojnë/kërkojnë produkte, shërbime, teknologji apo zhvillim të inovacionit.

Në këtë numër:

Konferenca EEN-Albania	2
Takime B2B	2
EEN Info Day	2
Aktivitete të tjera	3
Oferta – Kërkesa	3
Partnerët EEN-Albania	4

SHËRBIMET TONA:

- Akses në Tregje
- Transferim teknologjie
- Akses në financë
- Programe të BE-së
- Legjislacion dhe standarde
- Pronësia Intelektuale



Business Support on Your Doorstep

EEN-Albania



## KONFERENCA “LANÇIMI I RRJETIT EUROPIAN TË NDËRMARRJEVE NË SHQIPËRI”

Me dt. 20 Maj pranë Tirana Business Park, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), zhvilloj aktivitetin me temë "Prezantimi i Rrjetit European të Ndërmarrjeve"- Enterprise Europe Network në Shqipëri". Gjatë kësaj periudhe AIDA ka dhënë informacion dhe mbështetje për kompanitë shqiptare në mbështetje të biznesit të tyre, mundësi financimi, informacion mbi fondet e ofruara nga buxheti i shtetit dhe të menaxhuara nga AIDA, si dhe përfitimet e partneritetit në Rrjetin European të Ndërmarrjeve Pjesëmarrës në panel ishin prezentë

Zv/Ministrja e MZHETTS-it, Znj. Adela Karapici, Drejtori Ekzekutiv i AIDA-s, Z. Genti Beqiri, përfaqësues të projektit të BE-së dhe Ministrisë së Integritit. Z. Genti Beqiri me fjalën e tij përshëndetëse i uroi mirëseardhjen të pranishmeve dhe theksoi rëndësinë e projektit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri. Mesazhi më i rëndësishëm që përcolli kreu i AIDA në fjalën e tij ishte "Në emër të AIDAS dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes lutem që së bashku të shfrytëzojmë maksimalisht këtë oportunitet



**Paneli pjesëmarrës në aktivitet.**

në funksion të dhënies së mundësisë SME-ve Shqiptare, në zhvillimin e mëtejshëm të tyre, aksesin në tregjet konkurruese, për rritjen e kapaciteteve prodhuese, eksportuese, punësuese dhe menaxhuese, për të qenë më të aftë për të konkurruar në Tregun e Përbashkët të BE-së". Përfaqësues të Dhomave të Tregtisë rajonale, Shoqatat e Prodhuesve të Verërave, Plastikës dhe të tjerë prezent në takim u informuan me detaje mbi përfitimet që mund të marrin kompanitë, nga organizatat partnere shqiptare, antare të këtij Rrjeti.

## TAKIME B2B SHQIPËRI- MALTË

*“U bashkuan në takime B2B pesëmbëdhjetë përfaqësues të kompanive më të rëndësishme të Maltës”*

Duke vlerësuar nevojat e biznesit shqiptar për tregje të reja dhe për mundësi të ndryshme bashkëpunimi Në datat 17-18 shkurt, në ambientet e Hotel Tirana International është organizuar nën kujdesin e veçantë të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve –

AIDA, me mbështetjen e EEN, në vëmendje të plotë të presidentëve të Maltës dhe Shqipërisë, Trade Malta, dhe Biznes Albania, Forumi i Biznesit Shqipëri –Maltë. Në kuadër të anëtarësimit në rrjetin EEN u bashkuan në takime B2B pesëmbëdhjetë përfaqësues të kompanive më

të rëndësishme të Maltës në sektorë të tillë si: infrastrukturë, turizëm, energji, akuakulturë, shërbime konsulence, që për dy ditë me radhë u takuan me partnerët e tyre shqiptarë për të shkëmbyer përvoja dhe për të ndarë interesa të përbashkëta .



**Momente nga aktiviteti i zhvilluar në kuadër të EEN.**

Me dt. 4 Maj 2016 në kuadër të projektit EEN, BiznesAlbania zhvilloi një INFODAY për njohjen më të gjerë të rrjetit të ndërmarrjeve nga partneret social, si dhe sfidat që ata hasin në kontratat kolektive ku rol të veçantë ka ndryshimi i mendësive tradicionale në pajtueshmërinë e punës dhe jetës familjare dhe barazinë gjinore. Aktiviteti u përshëndet

## EEN INFO DAY

nga Drejtori i Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë për BiznesAlbania Z. Koli Sinjari, i cili në fjalën e tij theksoi rëndësinë e rrjetit EEN. Gjithashtu aktiviteti u përshëndet dhe nga Znj. Maria Gomes, eksperte e ILO, në prezantimin e saj theksoi situatën në Shqipëri dhe rolin e dialogut social, barazisë gjinore dhe zbatimi i kontratave

kolektive, duke vazhduar me prezantimin e Zv. Presidentes së Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë Znj. Anisa Subashi mbi hartimin dhe zbatimin e tyre me kuadrin ligjor të Kodit të Punës në Shqipëri. Gjatë takimit u zhvilluan diskutime përfaqësues të Shoqatës së Ndërtuesve, Fasonerisë dhe Bukës.

## AKTIVITETE TË TJERA PËR EEN- ALBANIA

Janë organizuar 3 misione Biznesi nga CCIT ( Bullgari, Maqedoni, Kroaci).

Janë dhënë më shumë se 14 mbështetje këshilluese mbi markat dhe patentat.

U është ofruar mbështetje këshilluese individuale me shume se 25 klientëve

U bë i mundur promovimi i Rrjetit gjatë të treja ditëve të

Panairit të Punës të organizuar në datat 28-30 Prill.

Më datë 10 Maj, pranë Sallës së Konferencave të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë u mbajt në kuadër të Enterprise Europe Network trajnimi me temë "Internacionalizimi i SME-ve".

Më datë 9 Maj, nga Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë u organizua një veprimtari informuese për EEN dhe programe të tjera të Bashkimit European COSME.

Më datë 10 Maj në zyrat e EU Info Centre në Vlorë u zhvillua ditë informimi për programin COSME dhe EEN-Albania .



Foto nga trajnimi me temë "internacionalizimi i SME-ve"

## OFERTA — KËRKESA — OFERTA

### BULLGARI

Kompania kërkon të bashkëpunojë me kompani shqiptare, që merret me tregtimin dhe prodhimin e vinçave dhe pajisjeve ngritëse.

### HOLLANDE

Një kompani holandeze kërkon zgjerim biznesi në Shqipëri si dhe partner që mund të shërbejë si shpërndarës i teknologjisë të njësive të trajtimit dhe pastrimit të ujërave të ndotura. Kjo njësi mund të aplikohet për ujëra të ndotura në sasi 2-5000 persona dhe në fusha si industri, turizëm si dhe në njësi bashkiake, në sasi deri në 200 litra. Kjo njësi teknologjike mund të jetë sidomos e përdorshme në jahte dhe zotërues varkash 10-15m të gjatë.

### LETONI

Kompania kërkon kompani që ofrojnë asistencë në procesin e zhvillimit të franchise, dhe që ndihmojnë në zhvillimin e modelit të biznesit të franchise nga fillimi deri në fund.

### POLONI

Kompania polake kërkon partner biznesi në Shqipëri që dizajnon dhe prodhon pajisje për produkte të veçanta, makineri të veçanta dhe linja prodhimi, prodhim kontenerësh me çelik rezistent ndaj acidit me rrota ose këmbë. Produktet ofrohen në versionin standart, në version më të qëndrueshëm në rast presioni në vakum dhe në version me nxehje ose ftohje.

[info@een.al](mailto:info@een.al)

*Lutemi kontaktoni në*

*këtë adresë emaili.*

*Një prej Organizatave*

*Partnere të*

*EEN-ALBANIA*

*do t'ju kontaktojë për*

*t'ju dhënë*

*informacione të*

*mëtejshme për ofertat*

*e paraqitura, por edhe*

*për të tjera sipas*

*fushës tuaj të interesit*

# ORGANIZATAT PARTNERE TË RRJETIT EEN- ALBANIA



**Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).** Objektivat kryesore të AIDAs janë tërheqja e investimeve të huaja, rritja e konkurrueshmërisë së ekonomisë Shqiptare nëpërmjet mbështetjes të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe inovacionit.

**Adr:** Tirana Business Park; **E-mail:** [info@aida.gov.al](mailto:info@aida.gov.al); **Web:** [aida.gov.al/home](http://aida.gov.al/home)



**Agjencia e Kërkimit, teknologjisë dhe Inovacionit (AKTI).** Krijimi i AKTI synon ndërtimin e një sistemi modern të shkencës, fuqizimin e kërkimit shkencor dhe teknologjik, si dhe integrimin e tyre në sistemin e arsimit të lartë.

**Adr:** Rruga "Papa Gjon Pali II"; **E-mail:** [info@akti.gov.al](mailto:info@akti.gov.al); **Web:** [www.akti.gov.al/index.html#7](http://www.akti.gov.al/index.html#7)



**Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë ( CCIT ).** Misioni i CCIT është të ndihmojë përparimin e biznesit duke mbështetur modernizimin, udhëheqjen, inkurajimin dhe promovimin e interesave të biznesit dhe vendosjen e marrëdhënieve afat-gjata me partnerët kryesorë të biznesit.

**Adr:** Rr. Kavajës Nr.6 Tiranë; **E-mail:** [sekretaria@cci.al](mailto:sekretaria@cci.al); **Tel** +355 45 800 932; **Web:** [cci.al](http://cci.al)



**Regional Development Agency ( RDA).** Një nga objektivat e agjnsisë është të zhvilloj kapacitetet e saj si një qendër kryesore në rajon duke ofruar trajnime, shërbime këshillimi dhe informacion për komunitetin e biznesit, OJQ-ve, qeverisë etj.

**Adr:** Rr. Ismail Qemali Pall 34/1, Tiranë;



**Qendra për Promovimin e Konkurrueshmërisë (CCP).** Në fushën e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla të mesme, Qendra mbështet rritjen e konkurrueshmërisë së biznesit nëpërmjet promovimit të biznesit, vlerësimit të gatishmërisë së kompanive për inovacion, përgatitjeve të planeve të biznesit apo marketingut, promovimit të eksporteve të mallrave, menaxhimit të burimeve njerëzore.

**Adr:** Rr. "Hamid Shijaku" P.6, Tiranë; **E-mail:** [alida.kondi@gmail.com](mailto:alida.kondi@gmail.com); **Tel** +355 692141920; **Web:** [www.ccp.al](http://www.ccp.al)



**BiznesAlbania (BizAlb).** Qëllimi i krijimit të "BiznesAlbania" është përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të BiznesAlbania, të grupuar në shoqata/organizata kombëtare, rajonale, sektoriale ose federata në të gjitha organet shtetërore publike dhe qeveritare, vendimmarrëse ose konsultative, aktuale dhe ato që do të krijohen në të ardhmen.

**Adr:** Rr. "Marko Boçari", pall.6 Tiranë; **E-mail:** [info@biznesalbania.org.al](mailto:info@biznesalbania.org.al); **Tel** +355 4 22 26 280; **Web:** <http://www.biznesalbania.org.al/>



**Instituti për Politika Publike dhe Mirëqeverisje (IPPM).** Misioni i Institutit në kuadër të projektit është që nëpërmjet informimit të gjerë të grupeve të interesit, analizave të detajuara sektoriale të ekonomisë Shqiptare, dhe suportit të drejtpërdrejtë të bizneseve Shqiptare të synoj të jetë një mbështetje e fortë e bizneseve në zgjerimin e tyre potencial në tregun e BE.

**Adr:** Blv. "Zogu I" Tiranë; **E-mail:** [sekretary@ippm.al](mailto:sekretary@ippm.al); **Tel** +355 67 205 5542; **Web:** [www.ippm.al](http://www.ippm.al)



**Instituti Agenda.** Misioni i Institutit Agenda është të forcoj dhe të promovojë vlerat demokratike gjatë procesit të debatit, analizës dhe implementimin e politikave publike në vend, të cilët do të drejtojnë Shqipërinë drejt integritimit Evropian .

**Adr:** Rr.Ymer Kurti Pall. Teknoprojekt 3, Tiranë; **E-mail:** [info@agendainstitute.org](mailto:info@agendainstitute.org); **Tel** +355 4 48 05 843; **Web:** [www.agendainstitute.org](http://www.agendainstitute.org)